



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
FERIZAJ

PLANI STRATEGJIK
I UNIVERSITETIT TË SHKENCAVE
TË APLIKUARA NË FERIZAJ
2022-2026

Ferizaj, 2022

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	i
LISTA E SHKURTESAVE	ii
FJALA E REKTORIT	1
HYRJE	2
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
METODOLOGJIA	5
ANALIZA E PROBLEMIT	6
VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT	8
Vizioni	8
Misioni	8
Vlerat	8
OBJEKTIVAT STRATEGJIKE	9
Objektivi Strategjik 1: Avancimi i procesit mësimor	9
Objektivi Strategjik 2: Ngritja e kapaciteteve në shkencë dhe inovacion	11
Objektivi Strategjik 3: Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin në nivel strategjik	13
Objektivi Strategjik 4: Ngritja e kapaciteteve institucionale	15
Objektivi Strategjik 5: Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë	17
RREZIQET DHE MASAT PËR MINIMIZIMIN E TYRE	19
MONITORIMI DHE RAPORTIMI	20
AKTIVITETET	22
BUXHETI	30
MATRICA E KORNIZËS LOGJIKE	31

LISTA E SHKURTESAVE

- BE** - Bashkimi Evropian
- FSHA** - Fakulteti i Shkencave të Aplikuara
- FSHTA** - Fakulteti i Shkencave Teknike të Aplikuara
- HERAS** - Higher Education, Research and Applied Science
- MASHT** - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
- QSHL** - Qendra e Shkollimit të Lartë
- SWOT** - Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats
- UShAF** - Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj
- TKP** - Treguesit Kryesor të Performancës

FJALA E REKTORIT

Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj është institucion i vetëm publik në Kosovë i specializuar në shkenca të aplikuara, me qëllim të edukimit të orientuar nga praktika dhe i lidhur me tregun e punës. Ky fakt, jo vetëm që bën UShAF-in si institucion të preferuar për të rinjtë kosovarë, por edhe ia shton përgjegjësitë dhe obligimet vetë institucionit për ofrimin e shërbimeve sa më cilësore në përmbushje të kërkesave të studentëve, komunitetit lokal dhe rajonal dhe mbi të gjitha bizneseve, si njëri ndër akterët më të rëndësishëm të UShAF-it.

Edhe pse i ri si universitet, tradita e punës akademike dhe shkencore në Ferizaj daton nga viti 1976, kur Kuvendi i Kosovës me Vendimin 692-2 themeloi Qendrën e Shkollimit të Lartë.

Numri në rritje i studentëve, me një numër relativisht të vogël të programeve (gjithsej katër programe bachelor), rritë sfidat dhe përgjegjësitë ndaj vetë UShAF-it për zhvillim të vazhdueshëm për të mbajtur hapin dhe plotësuar nevojat e bizneseve rajonale si dhe atyre kosovare.

Brenda një periudhe shumë të shkurtë që nga themelimi, UShAF ka ndërtuar një partneritet të mirë me shumë biznese, me të cilat edhe ka nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit.

Gjithashtu, UShAF gjatë kësaj kohe ka filluar bashkëpunimin me shumë universitete ndërkombëtare, me të cilat ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, është përfitues i katër projekteve Erasmus+ për ndërtimin e kapaciteteve, si dhe tri projekteve të mobilitetit të studentëve dhe stafit në kuadër të projektit Erasmus+.

Për të vazhduar kontinuitetin e logjikes së veprimit sipas planit strategjik, UShAF realizon Planin e ri Strategjik të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, për periudhën 2022-2026. Ky dokument do të adresojë gjatë pesë viteve në vijim çështjet që lidhen me ngritjen e cilësisë në të gjitha shërbimet e UShAF-it.

Kjo Strategji, identifikon dhe adreson masat dhe instrumentet që UShAF duhet të ndërmarrë që zhvillimi akademik të jetë i lidhur më ngushtë me tregun e punës, si akademike ashtu edhe ato profesionale, si dhe ndërkombëtarizimin e Universitetit dhe nevojat e shoqërisë në tërësi.

Menaxhmenti i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj është shumë i përkushtuar të zbatojë këtë Strategji, për të arritur rezultate të krahasueshme në nivel ndërkombëtar, si dhe të kontribuojë në zhvillimin socio-ekonomik të Republikës së Kosovës.

Me respekt,

Prof. Dr. Agron Bajraktari, rektor

HYRJE

Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) është institucion relativisht i ri i arsimit të lartë në Kosovë. Është themeluar me Vendim të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) të datës 6 korrik 2015, i ratifikuar në Parlamentin e Republikës së Kosovës, më 16 korrik 2015.

Në kuadër të UShAF aktualisht veprojnë pesë fakultete: 1) Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës, 2) Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit, 3) Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit, 4) Fakulteti i Arteve të Aplikuara dhe 5) Fakulteti i Menaxhimit.

Përndryshe, UShAF-i përbën institucionin e parë të arsimit të lartë në Kosovë të këtij lloji, një ekuivalent i sistemit të shkencave të aplikuara në hapësirat gjermanofolëse.

Edhe pse institucion i ri, UShAF-i që nga themelimi është dëshmuar për promovim të arsimit të lartë, përmirësim të vazhdueshëm të performancës së përgjithshme si dhe përshtatje me nevojat e tregut të punës, duke joshur kështu të rinj dhe të reja që të pajisen me dije të arsimit të lartë të profileve që ky universitet ofron.

Gjithsesi, përshtatja e arsimit të lartë me nevojat e punës mbetet sfidë e përgjithshme jo vetëm në UShAF, por në të gjitha institucionet e arsimit të lartë. Prandaj, në vitet në vijim - UShAF do të përpiqet që sa më shumë të profilizohet sipas nevojave dhe specifikave të tregut të punës në Kosovë dhe më gjerë, për t'iu përgjigjur kështu kërkesave të ndryshme dhe në rritje të bizneseve për kuadro sa më të përgatitura dhe pse jo të profilizuara. E tëra kjo, për të garantuar zhvillim të sektorit privat në vend dhe rritje të mirëqenies ekonomike për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Për të qenë në hap me kohën, UShAF si fillim ka nxjerrë Planin e parë Strategjik 2018-2020, mbi bazën e të cilit janë vënë binarët e mbarëvajtjes së punës së Universitetit.

Para se të skadojë afati i zbatimit të Planit paraprak Strategjik, UShAF-i ka filluar me përgatitjet dhe analizat e brendshme të nevojshme për hartimin e Planit pasues Strategjik. Plani i ri Strategjik përfshin periudhën 2022-2026 dhe përmban tërë logjikën e intervenimit duke filluar nga vizioni, misioni, vlerat, objektivat strategjike e specifike, planin e aktiviteteve, rreziqet potenciale, treguesit dhe caqet. Të gjitha këto janë definuar dhe përcaktuar duke u bazuar në rezultatet dhe mësimet e nxjerra nga plani strategjik paraprak si dhe nevojat e ardhshme të arsimit të lartë, për të rritur kështu cilësinë e arsimit si dhe për të përmirësuar performancën e përgjithshme të UShAF-it.

Përmbajtja dhe projeksionet e Planit Strategjik të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, 2022-2026, do të ndikojnë në përmirësimin dhe avansimin e përgjithshëm të procesit mësimor në UShAF, rritjen e cilësisë në arsim, ngritjen e kapaciteteve akademike dhe administrative, fuqizimin e partneriteteve si dhe zhvillimin e mësimi praktik sipas praktikave më të mira evropiane. Për më tepër, ky plan synon që ta ngrisë UShAF-in në një stad më të lartë zhvillimor të arsimit të lartë në Kosovë duke iu përgjigjur kështu dinamikave zhvillimore dhe tregut në rritje të ideve dhe punës. Përveç kësaj, përmes këtij plani synohet që të diplomuarit e UShAF-it të bëhen konkurentë jo vetëm vendorë, por rajonalë dhe më gjerë.

Si vizioni, misioni, ashtu edhe objektivat strategjike, specifike me tregues e caqe të definuara në këtë plan, janë bazuar në rrethanat, nevojat dhe specifikave e rajonit të Ferizajit dhe më gjërë të këtij, si dhe në kapacitetet institucionale (përfshirë resurset dhe buxhetin) të Universitetit

Me një fjalë, ky plan strategjik do të shërbejë si dokument planifikues i punës së UShAF-it për periudhën 2022-2026, dhe si dokument për vlerësimin e rritjes së performancës së përgjithshme të UShAF-it.

Dokumenti i Planit Strategjik nuk duhet konsideruar si i ngurtë, por si diçka evoluese, që do të plotësohet gjatë fazës së zbatimit, varësisht prej dinamikave dhe nevojave të shfaqura.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në përputhje me nevojat dhe projeksionet e UShAF-it, Plani Strategjik ka definuar logjikën e drejtimit dhe menaxhimit të Universitetit. Në plan janë dizajnuar Objektivat Strategjike dhe ato Specifike, të cilat pritet të arrihen gjatë periudhës 2022-2026. Po ashtu janë definuar treguesit dhe caqet, përmes të cilave do të bëhet matja e përmbushjes së Objektiveve Strategjike dhe atyre Specifike. Pjesë integrale e planit strategjik është Plani i aktiviteteve të afatizuara dhe me përgjegjës për zbatimin e secilit aktivitetet.

Plani strategjik ndërthet në vete të gjitha elementet e nevojshme të një dokumenti strategjik duke filluar me hyrjen, metodologjinë, përshkrimin e gjendjes aktuale duke nënvizuar sfidat dhe vështirësive që do të adresohen përmes Objektiveve Strategjike dhe Specifike.

Përmbushja e këtij Plani Strategjik është ndarë në pesë Objektiva Strategjike. Secila Objektivë Strategjike ndërthet në vete disa Objektiva Specifike, të cilat janë paraqitur në renditjen e mëposhtme:

Objektivi Strategjik 1: Avancimi i procesit mësimor
<i>Objektivat Specifike:</i> <i>1.1. Avancimi dhe përshtatja e kurikulave me trendët zhvillimore;</i> <i>1.2. Përmirësimi i vazhdueshëm i metodologjisë mësimore me studentin në qendër;</i> <i>1.3. Zhvillimi i mëtejshëm i mësimin praktik;</i> <i>1.4. Avancimi i sistemit e-learning;</i>
Objektivi Strategjik 2: Ngritja e kapaciteteve në shkencë dhe inovacion
<i>Objektivat Specifike:</i> <i>2.1. Përmirësimi i infrastrukturës për punë shkencore dhe inovacion;</i>

<p>2.2. <i>Ngritja e cilësisë në punën kërkimore shkencore dhe të aplikuar;</i></p> <p>2.3. <i>Bashkëpunimi vendor dhe ndërkombëtar për projekte shkencore;</i></p>
<p>Objektivi Strategjik 3: Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin në nivel strategjik</p>
<p>Objektivat Specifike:</p> <p>3.1. <i>Avancimi i bashkëpunimit me industrinë;</i></p> <p>3.2. <i>Fuqizimi i bashkëpunimit në dhe me komunitet;</i></p> <p>3.3. <i>Fuqizimi i rrjetit të alumnit;</i></p>
<p>Objektivi Strategjik 4: Ngritja e kapaciteteve institucionale</p>
<p>Objektivat Specifike:</p> <p>4.1. <i>Ngritja e kapaciteteve administrative dhe profesionale;</i></p> <p>4.2. <i>Avancimi i shërbimeve studentore;</i></p> <p>4.3. <i>Zhvillimi i infrastrukturës për aktivitete komerciale;</i></p>
<p>Objektivi Strategjik 5: Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë</p>
<p>Objektivat Specifike:</p> <p>5.1. <i>Avancimi i cilësisë dhe përshtatja e vazhdueshme e mekanizmave të sigurimit të cilësisë;</i></p> <p>5.2. <i>Adoptimi i mënyrës elektronike të vlerësimit të cilësisë në të gjitha nivelet e universitetit;</i></p> <p>5.3. <i>Identifikim i secilit anëtar të Universiteti me cilësinë (kultura e cilësisë);</i></p>

Plani Strategjik përmban kapitullin e monitorimit të zbatimit si dhe shpeshhtësinë e raportimit. Kjo do të jetë më se e rëndësishme për të siguruar orientimin e zbatimit sipas projeksioneve të definuara në këtë plan.

Për ta mbajtur kursin dhe projeksionet e dakorduara, janë identifikuar rreziqet të cilat potencialisht mund të ndodhin gjatë fazës së zbatimit si dhe masat për minimizimin e tyre. Strukturat e monitorimit të zbatimit të Planit Strategjik 2022-2026, do të jenë përgjegjëse për rishikimin e planit strategjik (nëse është e nevojshme), në përputhje me dinamikat që prekin arsimin e lartë në përgjithësi dhe UShAF-in në veçanti. Po ashtu struktura e monitorimit do të përkujdeset për analizimin dhe vlerësimin e rreziqeve, për t'i adresuar ato më pastaj në procesin e rishikimit.

METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur për hartimin e Planit Strategjik të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, 2022-2026 ka qenë gjithëpërfshirëse duke përfshirë strukturën menaxhuese të UShAF-it, atë akademike, administrative, studentore, biznesore dhe shoqërisë civile.

Gjatë fundit të muajit Korrik, të vitit 2021 menaxhmenti i UShAF-it ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të filluar me hartimin e planit të ri strategjik, për t'i dhënë orientim dhe shtytje të mëtejme zhvillimore universitetit. Në këtë kuadër është formuar Grupi Punues me të gjitha palët e nevojshme për hartimin e planit strategjik. Procesi i hartimit është mbështetur nga projekti HERAS+.

Hartimi i planit strategjik ka kaluar nëpër disa faza, të përshkruar më poshtë:

1. Faza e analizimit të situatës, përcaktimi i vizionit, misionit, vlerave - Paraprijëse e këtij aktiviteti ka qenë analizimi i zbatimit të planit strategjik të kaluar, analizimi i raporteve të akreditimit, si dhe i dokumenteve vendore e ndërkombëtare që lidhen me arsimin e lartë në Kosovë. Në Korrik të vitit 2021 është organizuar një punëtori dyditore me të gjithë akterët përgjegjës për hartimin e planit të ri strategjik, ku janë bërë diskutime frytdhënëse për orientimin dhe pritjet e UShAF-it për periudhën 2022-2026.

Mbi këtë bazë më pas është zhvilluar analiza SWOT, ku janë identifikuar faktorët e brendshëm universitarë (përparësitë dhe dobësitë) si dhe ata të jashtëm (mundësitë dhe rreziqet). Duke qenë se vizioni, misioni dhe vlerat e planit strategjik të kaluar parashihnin projeksione të mjaftueshme edhe për periudhën 2022-2026, atëherë në këtë punëtori dyditore ato vetëm janë përplotësuar.

2. Faza e identifikimit të problemeve, përcaktimit të objektivave dhe aktiviteteve – Kjo fazë ka të bëjë me identifikimin e problemeve duke marrë si pikënisje analizën SWOT. Gjatë kësaj faze janë identifikuar pesë fushat orientuese kryesore, mbi bazën e të cilave pastaj është ndërtuar analiza shkak-pasojë. Për secilën fushë janë identifikuar shkaqet dhe pasojat që prodhojnë ato probleme si dhe problemet kyçe. Më pas problemet kyçe janë kthyer në Objektiva Strategjike dhe Objektiva Specifike si dhe janë identifikuar aktivitetet e afatizuara për arritjen e secilës Objektivë Specifike.

3. Faza e identifikimit të rreziqeve, përcaktimi i treguesve dhe caqeve - Gjatë kësaj faze janë identifikuar rreziqet potenciale që do të mund të ndodhnin gjatë fazës së zbatimit të planit strategjik si dhe masat për minimizimin e tyre. Pastaj, është bërë përcaktimi i treguesve dhe caqeve që do të konfirmojnë përmbushjen e Objektivave Strategjike dhe Specifike si dhe kohën e përmbushjes së tyre.

4. Faza e përcaktimit të strukturave të monitorimit dhe raportimit - Gjatë kësaj faze janë përcaktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e planit strategjik, monitorimin dhe raportimin. Po ashtu është përcaktuar shpeshësia e raportimit, pastaj e rishikimit eventual të planit strategjik në mënyrë që zbatimi i tërësishëm i planit strategjik mos të devijojë nga orientimet, resurset dhe afatet e caktuara.

ANALIZA E PROBLEMIT

Tradita e arsimit të lartë në qytetin e Ferizajt filloi në vitin 1976, kur Kuvendi i Kosovës themeloi Qendrën e Shkollimit të Lartë (QSHL) në Ferizaj, e cila në vitin 1988 suprimohet dhe themelohet Shkolla e Lartë Teknike (SHLT).

Pas vitit 1999, kur institucionet e Kosovës filluar të ndërmerrnin hapat zhvillimorë në fushën e arsimit të lartë dhe jo vetëm, në vitin akademik 2002/2003 - u miratuan plan-programet e reja mësimore sipas Deklaratës së Bolonjës për studimet themelore. Në këtë kuadër, në Ferizaj filluan aplikimin sipas sistemit të Bulonjës, dy profilet për studime bachelor: (1) Teknika e përpunimit të Materialeve Artificiale dhe (2) Përpunimi i Drurit.

Ndërkohë që në vitin 2005, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës -transformoi SHLT në Fakultet të Shkencave Teknike të Aplikuara (FSHTA) dhe më pas në Fakultet të Shkencave të Aplikuara (FSHA), duke i mundësuar fakultetit të zhvilloj programe përtej atyre teknike.

Si Universitet Shkencave të Aplikuara, operon nga 16 Korrik 2016, kur vendimi i MASHT për themelimin e universitetit u ratifikuar në Parlamentin e Republikës së Kosovës.

Pra, që nga fillet e para të këtij institucioni, ideja ishte profilizimi fillimisht sipas specifikave të rajonit ku operon, duke u zgjeruar në përputhje me kërkesat e tregut të punës në Kosovë, dhe më gjerë. Edhe Plani Strategjik 2018-2020, edhe pse ambicioz, synonte profilizimin e UShAF-it sipas praktikave më të mira të BE-së të mësimin dual, teori dhe praktikë.

Bazuar në analizat e dokumenteve të ndryshme dhe diskutimeve të bëra janë identifikuar pesë fusha kryesore, mbi bazën e të cilave do të punohet në këtë Plan Strategjik 2022-2026, në mënyrë që pas përfundimit të zbatimit UShAF-i të jetë në stade më të larta zhvillimore. Fushat e identifikuar me interes janë: vështirësitë në procesin mësimor, kapacitetet e kufizuara në shkencë dhe inovacion, një nivel i bashkëpunimit me komunitetin i pazhvilluar mjaftueshëm, kapacitete të kufizuara institucionale si dhe nevoja për ngritje të cilësisë së përgjithshme në UShAF.

Sa i përket vështirësive në **procesin mësimor**, UShAF-i, duke qenë një institucion i ri i arsimit të lartë, ka ende deficienca në kapjen e trendëve aktuale zhvillimore dhe nevojave të tregut të punës duke filluar nga rregullativa e përgjithshme ligjore, institucionale, programore, metodologjike, pastaj infrastruktura e përgjithshme (përfshirë IT-në) e deri te mësimi praktik që lë për të dëshiruar. Elemente të gjitha këto që, përpos që mund të mos u shërbejnë nevojave të tregut, ato për më tepër mund edhe të dekurajojnë interesin për studime të profileve që aktualisht ofrohen.


Vështirësitë tjera kanë të bëjnë edhe me **kapacitetet e kufizuara për punë kërkimore shkencore, inovacion**, duke filluar nga kapacitetet e kufizuara akademike në këtë drejtim, pastaj mungesa e sistemeve softuerike, buxheti i limituar për hulumtime dhe inovacion si dhe pamjaftueshmëria e përfshirjes nëpër projekte e rrjete vendore dhe ndërkombëtare që do të kontribuonin në ngritjen e nivelit në këtë drejtim.

Njëra ndër vështirësitë tjera ka të bëjë me **bashkëpunimin e universitetit me komunitetin**. Me një fjalë ende mungojnë planifikime e projeksione të qarta për t’iu përgjigjur mjedisit, veçorive dhe nevojave socio-ekonomike të rajonit. Deri me tani ndërlihdja dhe bashkëpunimi me komunitetin përreth nuk ka qenë –njëra ndër pikat e forta, e cila do të joshte mjaftueshëm p.sh. komunitetin e industrisë, të shfrytëzonte potencialin e universitetit në dobi të rritjes ekonomike dhe mirëqenies sociale të rajonit.

UShAF-i duke qenë një institucion i ri i arsimit të lartë ende nuk ka arritur që të ketë **kapacitetet institucionale** të mjaftueshme administrative e profesionale. Andaj, si efienca ashtu edhe efektiviteti i përgjithshëm janë për t’u adresuar duke filluar nga trajnimet brenda dhe jashtë vendit (përmes projekteve të ndryshme), pastaj dixhitalizimi i shërbimeve, e-learning e deri te kapacitetet për aktivitete komerciale.

Vështirësi tjetër me të cilën përballlet UShAF është edhe **cilësia e përgjithshme**, e cila nuk është në stadet më të mira të mundshme. Si e tillë, është ndër pikat që vazhdimisht kërkohet të përmirësohet nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.

Të gjitha këto elemente, të cilat do të adresohen përmes objektivave strategjike e specifike janë përmendur edhe në analizën e mëposhtme SWOT.



VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT

Vizioni

Model kombëtar i një universiteti modern, inovativ dhe i edukimit integruar, ku praktika plotëson teorinë dhe zhvillohen aftësi profesionale e hulumtuese për të mirën e shoqërisë.

Misioni

Jemi të përkushtuar të ofrojmë arsim cilësor, që të përgatisim profesionistë të kualifikuar, hulumtues të përkushtuar dhe qytetarë të edukuar e të përgjegjshëm për të zhvilluar një karrierë profesionale dhe për të udhëhequr një jetë produktive.

Vlerat

- **Të mësuarit:** Universiteti vlerëson arsimin, i cili është i orientuar drejt punësimit, balancon teorinë dhe praktikën, fokuson mësimin aktiv dhe të menduarit kritik dhe nxitë përgjegjësinë dhe dëshirën për mësimin tërë jetësorë.
- **Etika:** Universiteti trajton dinjitetin e secilit anëtar të tij me respekt, ndershmëri, barazi dhe integritet, duke përkrahur lirinë akademike.
- **Bashkëpunimi:** Ndërtimi i partneriteteve me studentë, alumni, biznese dhe industri, institucione qeveritare vendore dhe ndërkombëtare, Agjencinë e Akreditimit dhe komunitetit të cilit Universiteti i shërben.
- **Përsosmëria:** Ne përpiqemi të jemi të përsosur dhe ekselent në edukim, krijimtari shkencore dhe inovacione.
- **Diversiteti:** Përqafojmë idetë, besimet, kulturat dhe etnitetet e ndryshme.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Objektivi Strategjik 1: Avancimi i procesit mësimor

Për të avancuar procesin e tërësishëm mësimor në USHAF në linjë me trendët zhvillimore janë paraparë këto Objektiva Specifike:

<i>1.1. Avansimi dhe përshtatja e kurrikulave me trendët zhvillimore;</i>	<i>1.2. Përmirësimi i vazhdueshëm i metodologjisë mësimore me studentin në qendër;</i>	<i>1.3. Zhvillimi i mëtejshëm i mësimin praktik;</i>	<i>1.4. Avancimi i sistemit e-learning;</i>
---	--	--	---

Të gjitha këto objektiva specifike do të kontribuojnë në përmbushjen e objektivit strategjik të mësipërm. Për të përmbushur këto pesë objektiva specifike, UShAF do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që në përputhje me dinamikat zhvillimore, trendët dhe nevojat e tregut t'ua përshtatë atyre kurrikulat duke e vënë studentin në qendër të të gjitha zhvillimeve, duke rritur cilësinë e kurrikulave gjithmonë duke marrë parasysh përvojat më të mira të vendeve të BE-së, duke iu siguruar mësimin e nevojshëm praktik, duke avancuar sistemin e-learning në mënyrë që studentët të kenë qasje elektronike në literaturë të përshtatshme dhe në trend.

Matja për arritjen e objektivave specifike të kësaj fushe bëhet përmes treguesve dhe caqeve si në vijim:

Objektivi strategjik 1. Avancimi i procesit mësimor					
Objektivi specifik 1.1. Avancimi dhe përshtatja e vazhdueshme e kurrikulave me trendët zhvillimore					
Treguesit	Caqet				
	2022	2023	2024	2025	2026
Rritja e interesimit të studentëve në programet që zbatojnë kurrikulat e përditësuara dhe të përafuara me trendët zhvillimore	10%	10%	10%	10%	10%
Kënaqshmëria e punëdhënësve me nivelin e shkathtësive të fituara nga të diplomuarit.	75%	75%	75%	75%	75%
Shkalla e punësimit të diplomuarëve në tregun e punës	80%	80%	80%	80%	80%

Objektivi specifik 1.2. Përmirësimi i vazhdueshëm i metodologjisë mësimore me studentin në qendër					
Treguesit	Caqet				
	2022	2023	2024	2025	2026
Numri i trajnimeve të organizuara për metodologji të mësimdhënies	1	1	1	1	1
Përqindja e numrit të lëndëve në program të cilat aplikojnë sistemin studentin në qendër	20%	30%	40%	50%	70%
Rritja kalueshmërisë së studentëve në provime në lëndët ku aplikohet studentin në qendër	10%	10%	20%	20%	30%
Rritja e suksesit (notës mesatare) të studentëve në lëndët ku aplikohet studentin në qendër	10%	10%	20%	20%	30%
Rritja e kënaqshmërisë së studentëve për lëndën që aplikohet studentin në qendër	5%	5%	10%	10%	15%

Objektivi specifik 1.3. Zhvillimi i mëtejshëm i mësimin praktik					
Treguesit	Caqet				
	2022	2023	2024	2025	2026
Përqindja e mësimin praktik në programe	20%	25%	30%	35%	40%
Kënaqshmëria e studentëve më mësimin praktikë në programe	20%	30%	40%	50%	70%
Kënaqshmëria e punëdhënësve me shkathtësit praktike të të diplomuarëve	60%	65%	70%	75%	80%
Kënaqshmëria e Alumnit me shkathtësit praktike të fituara gjatë studimeve	60%	65%	70%	75%	80%

Objektivi specifik 1.4. Avancimi i sistemit e-learning					
Treguesit	Caqet				
	2022	2023	2024	2025	2026
Numri i trajnimeve të organizuara për aplikimin e sistemit e-Learning për staf dhe studentë	3	4	4	5	5
Përqindja e studentëve të cilët përdorin platformën e-Learning	50%	60%	70%	80%	90%
Kënaqshmëria e studentëve me përdorimin e sistemit e-Learning	70%	75%	80%	85%	90%
Përqindja video-klasëve në program	10%	15%	20%	25%	30%

Objektivi Strategjik 2: Ngritja e kapaciteteve në shkencë dhe inovacion

Për të adresuar çështjen e ngritjes së kapaciteteve në shkencë dhe inovacion janë paraparë këto Objektiva Specifike:

<i>2.1.Përmirësimi i infrastrukturës për punë shkencore dhe inovacion;</i>	<i>2.2.Ngritja e cilësisë në punën kërkimore shkencore dhe të aplikuar;</i>	<i>2.3.Bashkëpunimi vendor dhe ndërkombëtar për projekte shkencore;</i>
--	---	---

Edhe për përmbushjen e objektivit strategjik të lartpërmendur, UShAF do të vazhdojë me përmirësimin e infrastrukturës së përgjithshme për punë shkencore dhe inovacion, qoftë ajo fizike apo dixhitale. Për të rritur cilësinë e punës kërkimore shkencore UShAF vëmendje të theksuar do t'i kushtojë bashkëpunimit me partnerë vendor e ndërkombëtarë nëpër projekte të ndryshme.

Ky bashkëpunim do të kontribuojnë së pari në ngritjen e kapaciteteve për punë kërkimore dhe shkencore, dhe në ngritjen e cilësisë së punës shkencore, e cila më pastaj do t'u shërbejë institucioneve për projeksione të ndryshme dhe komunitetit të biznesit i cili do të mund të përfitonte nga projektet inovative të UShAF-it.

Matja për arritjen e objektivave specifike të kësaj fushe bëhet përmes treguesve dhe caqeve si në vijim:

Objektivi strategjik 2. Ngritja e kapaciteteve në shkencë dhe inovacion					
Objektivi specifik 2.1. Përmirësimi i infrastrukturës për punë shkencore dhe inovacion					
Treguesit	Caqet				
	2022	2023	2024	2025	2026
Rritja e fondeve për mbështetje në hulumtime shkencore dhe inovacion	10%	10%	10%	10%	10%
Kënaqshmëria e stafit me infrastrukturën për punë shkencore dhe inovacion	65%	70%	75%	75%	80%
Kënaqshmëria e studentëve me infrastrukturën për punë shkencore dhe inovacion	65%	70%	75%	75%	80%
Numri i burimeve elektornike në të cilat institucioni ka qasje	6	6	7	9	10
Themelimi i qendrës së testimeve	-	-	1		
Numri i llojeve të testimeve në qendrën e testimeve	-	-	3	5	7

Objektivi specifik 2.2. Ngritja e cilësisë në punën kërkimore shkencore dhe të aplikuar					
Treguesit	Caqet				
	2022	2023	2024	2025	2026
Trajnime të vazhdueshme të stafit për avancimin punës shkencore dhe të aplikuar	1	1	2	2	2
Numri i projekteve kërkimore shkencore dhe të aplikuar të realizuar në bashkëpunim ndërmjet stafit akademik dhe studenteve	5	5	7	8	10
Numri i punimeve të publikuara në revista të indeksuara në Web of Sciences dhe Scopus	20	25	30	30	40
Numri i stafit që merr pjesë në konferenca të ndryshme ndërkombëtare	5	7	10	10	15
Organizimi i konferencave ndërkombëtare	-	1	1	1	1

Objektivi specifik 2.3. Bashkëpunimi vendor dhe ndërkombëtar për projekte shkencore;					
Treguesit	Caqet				
	2022	2023	2024	2025	2026
Numri i projekteve të reja ndërkombëtare në bashkëpunim me universitetet vendore / ndërkombëtare për ngritjen e kapaciteteve (KA2) të programit Erasmus+.	1	2	2	3	3
Numri i mobiliteteve të studentëve në universitete ndërkombëtare	3	3	4	4	5
Numri i mobiliteteve të stafit në universiteti ndërkombëtare	4	4	5	5	6
Anëtarësimi në asociacionet ndërkombëtare të universiteteve		1		1	1
Nënshkrimi i marrëveshjeve me institucione akademike ndërkombëtare	1	1	1	2	2
Numri i ligjëruesve vizitor (guest lecturer) vendor dhe ndërkombëtar në universitet	5	7	8	10	10
Rrjetëzimi i laboratorëve në fushën e hulumtimit			1	1	1

Objektivi Strategjik 3: Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin në nivel strategjik

Për ta përmbushur këtë objektive strategjike janë paraparë këto Objektiva Specifike:

<i>3.1. Avansimi i bashkëpunimit me industrinë;</i>	<i>3.2. Fuqizimi i bashkëpunimit në dhe me komunitet;</i>	<i>3.3. Fuqizimi i rrjetit të alumnit;</i>
---	---	--

Duke qenë se USHAF përbën institucionin e parë të këtij lloji të arsimit të lartë në Kosovë, ku praktika plotëson teorinë dhe nga ana tjetër ekonomisë së Kosovës i mungojnë universitetet duale (studime e punë praktike të pandashme), atëherë USHAF-i përmes tri objektivave specifike të lartpërmendura do t'i kushtojë vëmendje të theksuar këtij sistemi të studimit, për të thelluar më tej dallimin.

Krijimi i një kornize adekuate rregullative, të bazuar në përvoja të vendeve të BE-së, për bashkëpunim me industrinë, me komunitetin si dhe me rrjetëzimin e rrjetit të alumnit do ta bëjë UShAF-in joshës për të gjithë të interesuarit që të studiojnë aty, ashtu siç do ta bëjë UShAF-in pikë reference për industrinë dhe komunitetin në funksion të tregut të punës për rajonin e Ferizajt dhe më gjerë.

Matja për arritjen e objektivave specifike të kësaj fushe bëhet përmes treguesve dhe caqeve si në vijim:

Objektivi 3. Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin në nivel strategjik					
Objektivi specifik 3.1. <i>Avancimi i bashkëpunimit me industrinë</i>					
Treguesit	Caqet				
	2022	2023	2024	2025	2026
Numri i marrëveshjeve të reja të nënshkruara me bizneset vendore	5	5	5	6	6
Numri i partneriteteve strategjike	5	5	4	3	3
Numri i aktiviteteve të përbashkëta me Bordin Industrial (avancimi i programeve, panairë pune, ekspozita, etj)	2	2	3	3	4
Numri i shërbimeve/trajnimeve profesionale të ofruara në biznese	2	2	3	3	4
Themelimi i qendrës për transfer të njohurive (Knolwedge Transfer Center)		1			
Themelimi i qendrës për edukim të vazhdueshëm profesional			1		

Objektivi specifik 3.2. <i>Fuqizimi i bashkëpunimit në dhe me komunitet;</i>					
Treguesit	Caqet				
	2022	2023	2024	2025	2026
Themelimi i trupës koordinuese trepalëshe Universiteti-Komuna-Komuniteti (biznese, OJQ, Shoqata dhe institucione tjera etj) (UKK) për		1			

planifikimi dhe organizimin e aktiviteteve në dhe për komunitin					
Numri i aktiviteteve të trupës UKK		3	4	4	5
Numri i angazhimeve të stafit akademik / studentëve në aktivitete në shërbim të komunitetit	2	2	3	3	4
Shkëmbim përvojash me mërgatën, ekspert dhe personalitete	1	2	2	3	3

Objektivi specifik 3.3. <i>Fuqizimi i rrjetit të alumnit;</i>					
Treguesit	Caqet				
	2022	2023	2024	2025	2026
Numri i takimeve të rregullta me Alumni	1		1		1
Numri i aktivitete (forumeve) Universitet-Industri-Alumni	3	5	5	5	5

Objektivi Strategjik 4: Ngritja e kapaciteteve institucionale

Për të arritur këtë objektivë strategjike janë paraparë këto objektiva specifike:

<i>4.1. Ngritja e kapaciteteve administrative dhe profesionale;</i>	<i>4.2. Avancimi i shërbimeve studentore;</i>	<i>4.3. Zhvillimi i infrastrukturës për aktivitete komerciale;</i>
---	---	--

Njëri ndër fokuset kryesore të UShAF-it, kryesisht edhe për faktin se është institucion i ri, do të jetë ngritja e kapaciteteve administrative dhe profesionale, për të përmirësuar shërbimet studentore konform përvojave më të mira të vendeve të BE-së si dhe për të zhvilluar instruktuarën e nevojshme për aktivitete komerciale. Në këtë kuadër UShAF do të shfrytëzojë edhe projekte të ndryshme të donacioneve të jashtme, jo vetëm për t'i ngritur kapacitetet administrative dhe profesionale, por edhe për t'i bërë ato sa më të qëndrueshme.

Matja për arritjen e objektivave specifike të kësaj fushe bëhet përmes treguesve dhe caqeve si në vijim:

Objektivi strategjik 4. Ngritja e kapaciteteve institucionale					
Objektivi specifik 4.1. Ngritja e kapaciteteve administrative dhe profesionale;					
Treguesit	Caqet				
	2022	2023	2024	2025	2026
Rritja e numrit të stafit administrativ		5	5	4	4
Rekrutimi i stafit profesional (laborantëve)		4	4	5	5
Rritja e stafit akademik		4	5	5	5
Organizimi i trajnimeve për punë në laboratore të stafit	2	2		3	3

Objektivi specifik 4.2. Avancimi i shërbimeve studentore					
Treguesit	Caqet				
	2022	2023	2024	2025	2026
Niveli i kënaqshmëria e studentëve me shërbimet në universitet	90%	90%	95%	95%	95%
Kënaqshmëria e studentëve me shërbimet elektronike	90%	90%	95%	95%	95%
Numri i botimeve në bibliotekën e universitetit	20	30	30	40	40
Numri i hapësirave sociale të studentëve brenda universitetit	1	1		1	
Numri i mundësive vet-shërbyese për studentë		3	2	2	2

Objektivi specifik 4.3. Zhvillimi i infrastrukturës për aktivitete komerciale;					
Treguesit	Caqet				
	2022	2023	2024	2025	2026

Numri i shërbimeve komerciale të ofruara nga universiteti		1	3	5	5
Rritja e të hyrave vetanake nga shërbimet komerciale		5%	7%	10%	10%
Numri i stafit akademik i angazhuar në aktivitete komerciale		3	6	8	10
Numri i patenteve të regjistruara nga universiteti			1	1	2

Objektivi Strategjik 5: Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë

Për të arritur këtë objektivë strategjike janë paraparë këto objektiva specifike:

<i>5.1. Avansimi i cilësisë dhe përshtatja e vazhdueshme e mekanizmave të sigurimit të cilësisë;</i>	<i>5.2. Adoptimi i mënyrës elektronike të vlerësimit të cilësisë në të gjitha nivelet e universitetit;</i>	<i>5.3. Identifikimi i secilit anëtar të Universiteti me cilësinë (kultura e cilësisë);</i>
--	--	---

Përmirësimi i cilësisë është synim i vazhdueshëm i USHAF-it. Prandaj, USHAF-i gjatë kësaj periudhe sa mbulon ky Plan Strategjik do të punojë në avancimin e të gjithë mekanizmave për ngritje të cilësisë duke filluar nga ata rregullativ procesorë, infrastrukturorë (përfshirë IT-në), kuadrovik, për të krijuar gradualisht kështu një kulturë cilësie që është sa më afër praktikave ndërkombëtare si dhe veçorive socio-ekonomike të rajonit të Ferizajt. Matja për arritjen e objektivave specifike të kësaj fushe bëhet përmes treguesve dhe caqeve si në vijim:

Objektivi strategjik 5. Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë					
Objektivi specifik 5.1. Avancimi i cilësisë dhe përshtatja e vazhdueshme e mekanizmave të sigurimit të cilësisë;					
Treguesit	Caqet				
	2022	2023	2024	2025	2026
Niveli i përputhshmërisë së programeve me standartet e sigurimit të cilësisë të vlerësuara nga ekspertët ndërkombëtar.	80%	85%	90%	95%	95%

Niveli i përputhshmërisë së standarteve të universitetit me standartet e sigurimit të cilësisë të vlerësuara nga ekspertët ndërkombëtar.		90%			95%
Rishikimi dhe avancimi i mekanizmave të sigurimit të cilësisë	1	1	1	1	1
Gatishmëria e akterëve (në përqindje) të jashtëm në pjesëmarrje në proceset e sigurimit të cilësisë në universitet (industria, Alumni, etj)	60%	60%	70%	70%	70%

Objektivi specifik 5.2. *Adoptimi i mënyrës elektronike të vlerësimit të cilësisë në të gjitha nivelet e universitetit*

Treguesit	Caqet				
	2022	2023	2024	2025	2026
Organizimi i trajnimit për staf akademik për vlerësimin elektronik të cilësisë	1		1		
Niveli i përdorimit të vlerësimit elektronik nga stafi akademik	60%	60%	70%	80%	80%
Kënaqshmëria e studentëve me procesin e vlerësimit elektronik të cilësisë	80%	80%	80%	90%	90%

Objektivi specifik 5.3. *Identifikim i secilit anëtar të Universiteti me cilësinë (kultura e cilësisë)*

Treguesit	Caqet				
	2022	2023	2024	2025	2026
Numri i punëtorive të sigurimit të cilësisë të organizuara në universitet	2	1	2	1	2
Gatishmëria e stafit dhe studentëve me qene pjese cilësisë në universitet	80%	80%	80%	90%	90%
Kënaqshmëria e studentëve dhe industrisë me nivelin e cilësisë së shërbimeve në universitet	85%	85%	90%	90%	95%

RREZIQET DHE MASAT PËR MINIMIZIMIN E TYRE

Ashtu si në çdo dokument strategjik, identifikimi i rreziqeve potenciale është pjesë integrale e ciklit të planifikimit strategjik. Ndaj, pas analizimit të gjendjes aktuale si dhe dinamikave e zhvillimeve në ardhje, nga diskutimet e hollësishme brenda dhe jashtë universitetit janë identifikuar disa rreziqe, të cilat potencialisht mund të ndodhin gjatë fazës së zbatimit të këtij plani strategjik. Ato janë: stabiliteti politik i vendit, ndryshimet demografike, pandemia COVID 19 dhe shkurtime buxhetore.

Stabiliteti politik i vendit - Duke marrë parasysh gjendjen politike nëpër të cilën po kalon Kosova, më konkretisht problemin e pazgjidhur me Serbi, atëherë ekziston mundësia që fokusi i spektrit politik të kanalizohet më shumë në dialogun me Serbi sesa në probleme të brendshme, siç është p.sh. Arsimi i lartë. Strukturat drejtuese të USHAF-it do të jetë shumë azhur në këtë drejtim, për të minimizuar nëse jo evituar tërësisht çfarëdo shpërqendrimi nga lartë. Kjo për arsye se USHAF ka një bazë solide ligjore primare dhe sekondare, konform kësaj do të orientojë të gjitha planifikimet e nevojshme ashtu sikundër që do të jetë i përqendruar që të zbatojë të gjitha planet dhe të arrijë objektivat përcaktuara institucionale.

